



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:292217

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05727501

2023:292218

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL – gjyqtarja e vetme gjykuese Hakile Ilazi, me pjesëmarrjen e praktikantes së kësaj gjykate Altinë Maliqi zyrtarin, në çështjen penale kundër të pandehurit B.S., për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj me numër PP/II.nr.1827/23 e datës 20.12.2023, në praninë e prokurorit të shtetit Abdullah Abedini, të dëmtuarës K.L. si dhe të pandehurit B.S., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më datë 08.05.2024, mori dhe publikisht shpalli, kurse me datë 23.05.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: B.S., i lindur më, në Ferizaj, nga i ati B. dhe e ëma Xh..., e vajzërisë K. me vendbanim në rrugën “..” nr.1..., Komuna Ferizaj, puntorë fizik, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal ...

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datë 20 Nëntor 2023, rreth orës 10:00, në rrugën ... në Ferizaj, përkatësisht në restorant “M.”, i pandehuri me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ka vjedhur në dëm të të dëmtuarës K.L., në atë mënyrë që përderisa kishte qenë duke i bartur disa pije, e merr telefonin e markës “Iphone 11”, i cili kishte qenë i vendosur në një tavolinë në afërsi të banakut duke u mbushur me mbushës, me ç’rast me të identifikuar dhe ndaluar i njëjti nga zyrtarët policor, i është sekuestruar telefoni në fjalë,-

me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK- së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 48, 50, 69 dhe 70 të KPRK-së si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurin e

GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 / tre / MUAJ, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës kohore prej 1 / një / VITI pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet dhe

Me dënim me gjobë në shumën prej 200€ / dyqind / euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguajë në afat prej 30 / tridhjetë / ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, i njëjti në pajtim me nenin 43 par.3 të KPRK-së do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që një ditë burgim do të jetë ekuivalente me 20 €/njëzet/ euro gjobë të pa paguara.

E dëmtuara K.L. me vendbanim në rrugën “R....” Komuna Ferizaj, ka heqë dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 € /njëzetë/euro, si dhe për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej 20 €

/njëzet/ euro, brenda afatit prej 30/ tridhjetë / ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr..../23 e datës 20.12.2023, e ka ngarkuar të pandehurit B.S., për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më datë 08.05.2024 në të cilin shqyrtim ishin të pranishëm prokurori i shtetit Abdullah Abedini, e dëmtuara K.L. si dhe i pandehuri B.S..

Pasi që gjykata e ka udhëzuar të pandehurin në kuptim të nenit 241 par.1 të KPPK-se dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, në pajtim me nenin 241 par.3 të KPPK-së shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, duke vepruar sipas nenit 241 par. 4 të KPPK-së i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I pandehuri B.S. lidhur me të drejtën për tu deklaruar lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që e ngarkon aktakuza, se pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare dhe se është i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimin të fajësisë, duke shtuar se është penduar thellë, ka kërkuar falje publike, thekson faktin se është i gjendjes së dobët ekonomike, i njëjti shton se ka qenë hera e parë që ka kryer këtë veprë penale dhe ka premtuar se nuk do të përsërisë vepra të tilla penale si dhe e ka lutur gjykatën që të merr parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese dhe t'i shqiptojë një dënim më të butë.

Prokurori i shtetit Abdullah Abedini lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe konform nenit 242 të KPRK-së, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe ky pranim i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza andaj i ka propozuar gjykatës që të merrë parasysht pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ndërsa sa i përketë llojit dhe lartësisë së dënimit ka kërkuar që gjykata të marrë parasysht shkallën

e përgjegjësishë, dashjen e përfitimit të dobisë pasurore, ndërsa si rrethanë lehtësuese të marrë parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe të njëjtit t'i shqiptojë një dënim me të cilin arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 28 të KPRK- së.

E dëmtuara K.L. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale duke shtuar se nuk ka qenë vjedhje me peshë të rëndë, por e njëjta mendon se i pandehuri duhet të dënohet në mënyrë që të parandalohen vepra të tilla në të ardhmen, ndërsa sa i përketë kërkesës pasurore e njëjta heq dorë.

Meqë i pandehuri e ka pranuar fajësinë, gjyqtarja e vetme gjykuese ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 242 par.2 të KPPK-së, i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: video-incizimi i datës 20.11.2023, raporti i oficerit i datës 20.11.2023, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve, i datës 20.11.2023 si dhe vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësishtë, i datës 20.11.2023.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtarja e vetme gjykuese konform nenit 242 par. 6 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të përshkruar në datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se në shqyrtimin fillestar i pandehuri e ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, kërkim faljen publike, premtimin se nuk do ta përsërisë kurrë më në të ardhmen vepër penale, gjendjes së dobët ekonomike, faktin se i njëjti nuk ka rezultuar të ketë

qenë i gjykuar më parë me vendim të formës së prerë, ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe gjykata mori parasysh edhe peshën e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 452 paragrafi 1 lidhur me nenin 449 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

2023:292218, me datë 23.05.2024

Praktikantja

Altinë Maliqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Hakile Ilazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Ferizaj.